



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, 22 qershor 2015  
Nr. ref.:RK 806/15

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI165/14**

Parashtrues

**Bajram Ahmeti**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,  
Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar  
Arta Rama- Hajrizi, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Bajram Ahmeti, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati z. Ilaz Qerkinaj, nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013.
3. Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për këtë çështje në Rastin KI163/13, në të cilin parashtruesit e kërkesës kanë qenë *Naser Dragusha dhe 6 punëtorë të tjerë (në mesin e të cilëve edhe parashtruesi i kërkesës) të Korporatës Energjetike të Kosovës* (në tekstin e mëtejme: KEK). Aktvendimi për papranueshmëri në Rastin KI163/13, është nxjerrë nga Gjykata më 23 qershor 2014.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 25/2012] të Gjykatës Supreme, të 10 majit 2013, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 10 nëntor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 5 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI165/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI165/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
8. Më 17 dhjetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 6 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 10 nëntor 2014, parashtruesi parashtrroi kërkesën KI165/14, në të cilën si fakte dhe prova të reja në Gjykatë dorëzoi vetëm letrën e Misionit të EULEX-it, Ref: 2014-COS-1242, të 2 tetorit 2014.

11. Në letrën [Ref: 2014-COS-1242] e 2 tetorit 2014 të Misionit të EULEX-it, thuhet: *“Gjykata Kushtetuese tashmë e ka shqyrtuar rastin e parashtruesit dhe në lidhje me këtë, Gjykata, më datën 23 qershor 2014, e ka nxjerrë një vendim i cili është shënuar si Rasti KI163/13”*.
12. Në të vërtetë, më 18 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës së bashku me Naser Dragushën dhe 5 (pesë) punëtorë të tjerë të KEK-ut, parashtroi një kërkesë në Gjykatë, të cilën Gjykata e regjistroi me numrin KI163/13. Në atë kërkesë, parashtruesit e kontestuan Aktgjykimin e njëjtë të Gjykatës Supreme [Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013].
13. Në ndërkohë, më 23 qershor 2014, Gjykata e shpalli kërkesën KI163/13 të papranueshme, sepse ishte qartazi e pabazuar (Rasti KI163/13, Aktvendimi për papranueshmëri, i 23 qershorit 2014).
14. Faktet dhe vendimet e gjykatave të rregullta, të cilat janë paraqitur nga parashtruesi në kërkesën e re KI165/14, tashmë janë shqyrtuar në Rastin nr. KI163/13, siç është vendosur me Aktvendimin për papranueshmëri, të 23 qershorit 2014, dhe rrjedhimisht, vendimet të cilat tashmë kanë qenë objekt i shqyrtimit në Rastin KI163/13, Gjykata nuk do t'i merr në rishqyrtim.

#### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Në kërkesën e re KI165/14, parashtruesi insiston në pretendimin se me aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
16. Parashtruesi i kërkesës, në vazhdim, pretendon se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht të drejtën e tij për pagesën e të ardhurave personale.
17. Parashtruesi në përfundim të kërkesës së tij kërkon nga Gjykata që ajo t'ia mundësojë realizimin e të drejtës së tij për ndryshimin e pagave, në të cilat ai ka të drejtë.

#### **Pranueshmëria e kërkesës**

18. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 të Kushtetutës [Efekti Juridik i Vendimeve], i cili përcakton:

*Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.*

20. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 63 (1) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

*Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.*

21. Për më tepër, rregulli 36 (3) d) i Rregullores së punës, parasheh:

*Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*

*(...)*

*d) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri.*

22. Gjykata konsideron që faktet dhe pretendimet që parashtruesi i ka dhënë në kërkesën e re nuk paraqesin bazë dhe as arsye të mjaftueshme e relevante për vendim të ri (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI02/14, parashtrues i kërkesës *Hamdi Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 majit 2014).

23. Në fakt, Gjykata rikujton se ajo tashmë është marrë me çështjen e lartpërmendur në Rastin KI163/13, të parashtruesit të kërkesës *Naser Dragusha dhe të 6 punëtorëve të tjerë të KEK-ut*, Aktvendimi për papranueshmëri, i nxjerrë më 23 qershor 2014. Në aktvendimin e saj, Gjykata deklaroi kërkesën të papranueshme sepse ishte qartazi e pabazuar, duke konsideruar se faktet e paraqitura nga parashtruesit e atëhershëm të kërkesës në asnjë mënyrë nuk arsyetuan pretendimet e tyre për shkeljen e të drejtave kushtetuese, dhe se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme si dhe pse me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.

24. Prandaj, Gjykata konsideron se ajo tashmë ka nxjerrë një vendim për këtë çështje, dhe se kjo kërkesë nuk përmban asnjë bazë për nxjerrjen e një vendimi të ri.

25. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, me rregullin 63 (1) dhe me rregullin 36 (3) d) të Rregullores së punës, Gjykata përfundon se kjo kërkesë duhet të deklarohet e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, rregullin 63 (1) dhe rregullin 36 (3) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 qershor 2015, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit, dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**



Snezhana Botusharova

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani

